



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KESHILLI

Nr. 91/u Prot.

Koplik, më 7.03.2022

V E N D I M

Nr 8 datë 28 / 02 / 2022

**Per nje ndryshim në Vendimin nr.71, datë, 29.12.2021 të Keshillit Bashkiak Malësi e Madhe : “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së shtetasit z. Shyqyri Gjellaj.**

**Baza ligjore**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 28.02.2022,

Si dhe rregullorja e Keshillit Bashkiak Malesi e Madhe Nr.17 datë 30.04.2020 Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe

Në mbështetje të nenit 19,29 si dhe të nenit 54 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Në mbështetje të Ligjit nr.45/2019 datë, 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”.

Në mbështetje të Kreu III pika 1, gërma “ dh” si dhe të Kreu III pika 2, gërma “ ç” të VKM nr.329 datë

16/5/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Në mbështetje të Udhëzimit të përbashkët nr.263 datë 24/5/2013 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të

Financave, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” Kreu III – të.

Si dhe në mbështetje të shkresës nr. 48/1 prot, datë, 19.01.2022 të Prefektit të Qarkut Shkoder, protokolluar me tonën nr. 34/2 prot., datë 19.01.2022, propozojmë /relatojmë miratimin e VKB nr. 71, datë, 29.12.2022, sipas relacionit me ndryshimet/korigjimet përkatëse konstatuar gjatë shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur vendimit,

**V E N D O S I :**

1. Ndryshimin e Vendimit nr.71 datë ,29.12.2021 të Keshillit të Bashkisë Malësi e Madhe“ Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të shtetasit z. Shyqyri Gjellaj ,Për dhënien e ndihmës së menjëherëshme financiare nga fondi i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, nga programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr 70 datë 29.12.2022 “për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afat mesem 2022-2024 të Bashkisë Malësi e Madhe”. familjes së shtetasit z. Shyqyri Gjellaj , të dëmtuar nga rënia e zjarrit në banesë.



2. Kërkesa, mbështetur në dokumentacionin tekniko-ligjor me ndryshimet perkatëse sipas shkreses nr 48/1 prot datë 19.01.2022. të Prefektit të Qarkut Shkoder.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".



**KRYETAR**

Ilir Halaj

**SEKRETAR**

Emirjan Hasmujaj



Miratuar me 28.02.2022

Vota Pro 22

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 04.03.2022